



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“ZHVILLIMI DHE GËRSHETIMI I QASJEVE TË REJA
PEDAGOGJIKE DHE TEKNOLOGJIKE
NË MËSIMDHËNIEN DHE MËSIMNXËNIEN E GJUHËVE TË
HUAJA NË SISTEMIN PARAUNIVERSITAR NË SHQIPËRI, SI NJË
ZGJIDHJE PËR PERIUDHËN POST COVID-19”**

**FINANCUAR NGA AGJENCIA UNIVERSITARE E FRANKOFONISË
NË KUADËR TË THIRRJEVE PËR PROJEKTE NDËRKOMBËTARE POST
COVID-19**





EKIPI I PROJEKTIT:

Prof. Asoc. Dr. Ogerta KORUTI - Koordinatorë

Anetarë të personelit akademik:

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

Prof. Asoc. Dr. Anida KISI

Prof. Asoc. Dr. Etleva KONI

Prof. Asoc. Dr. Elvana SHTËPANI

Prof. Asoc. Dr. Alnida KOROSHI

Dr. Marisa JANKU

Anetarë të personelit ndihmës-akademik

Vasilika MULLA Marseda KOÇI

Malvina DEMNERI Rajmonda JAUPI

Elisa STRUGA Enio HODAJ

PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT:

Djetor 2021 – Dhjetor 2022

PARTNERË



Ky projekt përfshin partnerë në fushën e arsimit dhe shëndetësisë:

- **Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)**, që ka vepruar si një partner strategjik duke thelluar bashkëpunimin në dobi të mësuesve dhe nxënësve të arsimit parauniversitar.
- **Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASKAP)**, si burim i bazës së të dhënave për mësuesit dhe studentët si edhe duke ofruar ekspertizë për trajnimet e projekteve.
- **Qendra e Kujdesit dhe Mbështetjes Shëndetësore dhe Sociale (SPERO)**, duke ofruar ekspertizë në fushën e mbështetjes së shëndetit mendor për zhvillimin e trajnimeve.
- **Dhomat e Tregtisë**, duke lehtësuar lidhjet me bizneset.
- **Shoqatat e Mësuesve të Gjuhëve**, duke ndihmuar lidhjen me mësuesit në sistemin parauniversitar dhe gjithashtu kanë qënë një partner strategjik në zbatimin e aktiviteteve të projektit.

PËRSHKRIM I PROJEKTIT



Pandemia e COVID-19 ndër të tjera solli mbylljen e shkollave në nivel kombëtar nga cikli parashkollor deri në arsimin e lartë. Një sfidë e veçantë ka qenë kërkesa e menjëherëshme dhe e papritur për zhvendosjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies nga auditoret/klasat në mësimdhënie në distancë. Sfidat me të cilat mësuesit u përballën ishin shumë-dimensionale, pasi ata hasën vështirësi në planin personal dhe atë profesional.



Njohja me të gjitha këto sfida dhe nevojat me të cilat përballen mësuesit e arsimit parauniversitar u arrit nëpërmjet përpilimit dhe shpërndarjes së një pyetësor nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja.

Analiza e përgjigjeve dhe hartimi i një plan veprimi për trajnimin e mësuesve me qëllim informimin dhe praktikimin jo vetëm të qasjeve të reja pedagogjike dhe teknologjive të ndryshme, por edhe ndërgjegjësimin e tyre lidhur me hapat që duhet të ndjekin për të qenë më pranë nxënësve të tyre në situata të vështira si kjo e Covid 19, situatë me të cilën nxënësit dhe mësuesit u përballën për një periudhë të gjatë kohore.

QËLLIMI



→Projekti synon t'u japë mësuesve mbështetjen e nevojshme në përdorimin e teknologjisë në punën e tyre të përditshme, duke i informuar ata mbi strategji dhe aplikacione të cilat sugjerohen të përdoren nga mësuesit, nxënësit dhe jo vetëm, për të krijuar një mjedis sa të përshtatshëm aq dhe inovativ për periudhën në të cilën jetojmë si dhe për të nxitur zhvillimin digjital në arsimin parauniversitar.

→Nëpërmjet aktiviteteve, projekti synon gjithashtu të nxisë dhe sigurojë që mësuesit të kenë mbështetjen e duhur të shëndetit mendor, që do t'i ndihmojë ata të jenë të vetëdijshëm për ashpërsinë e rreziqeve në arsim të shkaktuara nga Pandemia dhe të marrin përgjegjësinë për të ofruar një proces sa më efikas të mësimdhënies në një mjedis sa më bashkëveprues dhe argëtues me nxënësit.

OBJEKTIVAT



- **Të identifikojnë problemet** dhe nevojat në lidhje me procesin e mësimdhënies/mësimit të gjuhëve të huaja dhe dimensionin psikosocial në sistemin parauniversitar, pas pandemisë Covid-19;
- **Të propozojnë zgjidhje** për përmirësimin dhe/ose përshtatjen e metodave të mësimdhënies dhe të nxënit pas pandemisë Covid-19;
- **Të mbështesin trajnimin e mësuesve** në përvetësimin e praktikave të reja pedagogjike dhe teknologjike si dhe trajnimin në aftësitë e buta;
- **Të ofrojnë mbështetje institucionale** si një udhëzues strategjik për të promovuar integrimin e teknologjive në procesin e mësimdhënies/të nxënit;
- **Të promovojnë bashkëpunimin** me sektorin privat dhe institucionet kërkimore duke ofruar shërbime konsulence dhe ekspertize;
- **Të promovojnë risi teknologjike** në procesin e mësimdhënies/mësimit.